



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

K O N T R A T Ë

E lidhur më datën 20/03/2018 ndërmjet palëve kontraktuese:

Komuna e Lipjanit të cilën e përfaqëson z.Adem Duriqi – Drejtor i Drejtoratit të Prokurimit në njërën anë, në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues, dhe N.N.P “KADOLLI” shpk, Godane i Epërm Shtime, të cilën e përfaqëson z. Fatmir Syla në anën tjetër në tekstin e mëtejme (kontraktuesi)

REALIZIMI NË SKULPTURË KUSHTUAR DËSHMORIT ARSIM ZEQIRI

Nr prokurimit 613 17 095 413

Lënda e Kontratës

Neni 1

Kontraktuesi obligohet me dispozitat e kësaj Kontrate të realizojë shtatoren e Dëshmorit Arsim Zeqiri sipas kërkesave të specifikuara të figurës së dëshmorit. Gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori fitues i konkursit, nëse e ndjen të nevojshme, mund të bëjë ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes kompozicionale me të cilën ka fituar konkursin, duke marrë pëlqimin paraprak të komisionit.

-Shprehja figurative artistike e shtatores duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizualisht me hapësirën oborrit të shkollës së fshatit Hallaq i Madh në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronzë; shtatorja e dëshmorit sipas buçetës së paraqitur dhe në bazë të se cilës është bërë edhe përzgjedhja.

Punimi i shtatores (lartësia duhet të jete -280 cm, e cila do të punohet në bazë të buçetit të ofruar me disa ndryshime të vogla të rekomanduara nga komisioni vlerësues.

Kontraktuesi siguron transportin dhe vendosë në postament, ku duhet të përfshihet, shënimi-gaverimi i emrit, mbiemrit, datën e lindjes dhe të vdekjes. Materiali i fortë përfundimtar i shtatores është bronzi.

Palët kontraktuese, janë pajtuar që kontraktuesi pas realizimit të shtatores nuk do të vendoset në bazament pa dhënjën e lejes nga komisioni i poshtëcekur dhe ndonjë nga familjarët e dëshmorit Arsim Zeqiri. Nëse komisioni jep pëlqimin për vendosje, atëherë kontraktuesi mund ta vendosë shtatoren në bazament dhe projekti të quhet i përfunduar.

Menaxhimi i Projektit

Neni 2

2.1. Me qëllim të koordinimit të punëve si bartës i detyrës caktohet komisioni:

- Burim Ramadani

Komisioni duhet të bashkëpunojnë me kontraktuesin rreth realizimit të shtatores, të krahasoj buçetin dhe Ofertën e kontraktuesit, specifikimet dhe detajet që mund të jenë rëndësishme për realizimin e kësaj shtatore.

2.3. Të paraqet me kohë të metat në projekt dhe të kujdeset për evitimin me kohë të tyre.

2.4. Të kujdeset për pagesën e shumës së kontraktuar të kontraktuesit.

2.5. Të pregadis raportin me shkrim mbi realizimin e shtatores, të njëjtin ta dërgoj në Drejtorinë e Prokurimit për pagesë.

Çmimi i

Neni 3

3.1. Autoriteti Kontraktues, obligohet që Kontraktuesit, në emër të çmimit të realizimit dhe vendosjes së Shtatores së dëshmorit Arsim Zeqiri, të paguaj shumën prej 68,000⁰⁰ € me fjalë (gjashtëdhjetë e tetëmijë euro).

Pagesa

Neni 4

Pagesa e parë do të kryhet gjatë realizimit të shtatores dmth në momentet që komisioni i lartcekur konstaton se kontraktuesi ka realizur rreth 40% të punimeve të shtatores, harton raportin për pagesën e parë, pjesa tjetër do të paguhet në momentin e vendosjes së shtatores në bazament dhe komisioni vlerëson se kontraktuesi ka arritur objektivat, dmth shtatorja i ka karakteristikat e dëshmorit Arsim Zeqiri.

Afati

Neni 5

4.1. Fituesi i kontratës obligohet që brenda 70 ditëve nga fillimi i afatit për punim të shtatores, ta sjellë shtatoren dhe ta vendosë në postament. Në çmim duhet të kalkuloohen të gjitha shpenzimet: punimi i shtatores, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament,

Afati fillon të rrjedh 10 ditë pas nënshkrimit të Kontratës.

Garancioni

Neni 6

Kontraktuesi do të garantojë për materialin e përdorur se do të jetë rezistencë ndaj kushteve klimatike me garancion bankar të rregullt 1 vjeçar pas pranimit teknik, kërkohet deklaratë mbi garancionin e cilësisë së punës dhe mallrave në kohëzgjatje 5 viteve nga dita e pranimit teknik

Kontraktuesi është përgjigjës për shtatoren deri në momentin e përrurimit dmth zbulimit të shtatores që njëherit konsiderohet pranim i punës së kryer.

Intuite persona

Neni 7

Kontraktuesi obligohet që tërë realizimin e shtatores ta kryej vet dhe nuk ka të drejt të ia besoj kryerjen e shërbimeve personave tjerë.

Sigurimi i ekzekutimit

Neni 8

Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vleres se kontrates për 100 ditë e cila duhet te paguhet me rastin e nënshkrimit te kontratës .

Dënimi kontraktues

Neni 9

9.1 Nëse Kontraktuesi me fajin e tij nuk arrin të realizojë punimin e shtatores ne afatin e kontraktuar, ndaj tij do te aplikohen penalet ne vlere prej 0.5% te vlerës se përgjithshëm te kontratës, për çdo dite vonese. Deri sa të arrijë vleren 10% të kontratës e nëse edhe atëherë nuk përfundon realizimi i shtatores nga kontraktuesi do të shkëputet kontrata në mënyrë të njëanshme dhe të konfiskohet sigurimi i ekzekutimit

Zgjidhja e kontesteve

Neni 10

10.1. Palët kontraktuese pajtohen që kontestet eventuale që lindin me rastin e mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga kjo kontrate t'i zgjedhin me mirëkuptim, e në rast të mos pajtimit çështja të kaloj për vendosje në Gjykatën Themelore në Lipjan.

Neni 11


11.1. Kjo kontrate është hartuar në katër (4) kopje identike, ku nga një kopje u jepet palave kontraktuese kurse dy të tjerat mbesin në dosje të tenderit.

PALËT KONTRAKTUESE:

PROJEKTUESI ;

Për kontraktuesin

z. Fatmir Syla



POROSITËSI

Për Autoritetin Kontraktues

z. Adem Duriqi

